



Hartimi i objektivave të OZHM për furnizimin me ujë dhe kanalizimet si dhe treguesit për kushtet lokale në ECA (Gjeorgji, Taxhikistan, Shqipëri)

Konteksti i projektit

Gjatë fazës së tranzicionit dhe me ndryshimet politike në fillim të viteve '90, sektori i ujit dhe kanalizimeve në Shqipëri kaloi nëpërmjet disa reformave problematike që vazhdojnë të kenë nevojë për zgjidhje. Pavaresisht nga përpjekjet e Qeverisë dhe ndihmës së donatorëve, gjendja me ofrimin e ujit të pijshëm dhe shërbimi i kanalizimeve të ujrave të zeza në veçanti në Shqipëri paraqitet në gjendje kritike, pothuajse në kushte të ngjashme me vendet e tjera në tranzicion.

Kjo gjendje ndikohet kryesisht nga niveli i lartë i dëmtimeve në infrastrukturë, rezultati i të cilave është humbja e madhe e ujit dhe shpesh shoqërohet me përzjerjen me ujrën e zeza, duke shkaktuar kështu ndotjen e ujit të pijshëm. Investimet nevojiten në të dy sektorët si në ujin e pijshëm ashtu edhe në kanalizimet e ujrave të zeza për 10 vitet në vazhdim në mënyrë që të arrihen standartet e BE, llogariten tek 150-170 Milion dollare amerikane, të paktën tre herë më shumë nga ç'është financuar deri tani. Situata është rënduar edhe si pasojë e nderhyrjeve ilegale në rrjet, si pasojë e migrimit të pakontrolluar nga zonat rurale në ato urbane.

Objektivi

Objektivi i shtatë "Sigurimi i pandërprerë mjedisor" i Deklaratës së Mijevjecarit- përfshin objektivin 10, i cili parashikon "përgjysmimin, deri në 2015, e raportit të njerezve pa mundësi për ujë të pijshëm të vazhdueshëm dhe kanalizime qendrore".



Zbatimi

Dy treguesit e strukture zyrtare globale, respektivisht 30 dhe 31, u projektuan për të matur zhvillimin në drejtim të objektivit 10 sipas Programit të Përbashkët të Monitorimit duke përfshirë vendet pilot të Gjeorgjisë, Taxhikistanit dhe Shqipërisë. Ky studim ofron kapitullin matjeve globale në këtë sektor për Shqipërinë. Aktualisht ka 30 kompani për ujin e pijshëm dhe kanalizimet e ujrave të zeza dhe 24 kompani që manaxhojnë vetëm ujin e pijshëm, pra 54 kompani që ofrojnë shërbimin për 65 bashki dhe për disa fshatra në 171 komuna. Ky studim synoi realizimin e një analize të nevojave për një zhvillim të pandërprerë të kapacitetit kombëtar të statistikave dhe sistemit të monitorimit të zhvillimit, duke përdorur një strukturë globale dhe një grup treguesish plotësues në shtetet pilote të Gjeorgjisë, Taxhikistanit dhe Shqipërisë.

Produkti kryesor

- Studim analitik treguesish, që shpjegon treguesit plotësues dhe metodën për

prezantimin e tyre, bashkë me treguesit e strukturës globale.

- Të dhënat analizuese për vendin që përfshijnë: Vlerësimin e cilësisë dhe përdorshmërisë së të dhënave; mbledhjen e të dhënave për strukturën globale dhe treguesit plotësues; përcaktimin e të dhënave bazë; itinerarin e pëlqyeshëm të OZHM (Objektivat e Zhvillimit për Mijevjecarin).
- Analiza e kostove dhe institucioneve të Shqipërisë për krijimin e një sistemi statistikor të besueshëm për monitorimin e treguesve plotësues.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ Instituti i Ekonomise Urbane
- ✓ Banka Botërore

KOHËZGJATIA:

Qershor 2005 – Gusht 2005

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtores Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.